



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 808/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Mal Lokaj kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Deçan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër Komisionarëve të Qendrave të Votimit për shkak të manipulimit dhe të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 11.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**HIDHET** si e palejueshme ankesa e Mal Lokaj kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Deçan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 08.11.2013, nga Mal Lokaj kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Deçan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendohet se në vendvotimet në Dranoc, Carabreg dhe Izniq komuna e Deçanit parashtruesi i ankesës dyshon se ka pasur manipulim të votave brenda subjektit politik LDK të cilit i përket edhe vet parashtruesi i ankesës. Ky manipulim sipas tij është bërë në orët e vona të datës 03.11.2013 me ç'rast të gjithë komisionarët dhe vëzhguesit e subjekteve tjera politike kanë lëshuar qendrat e votimit pas numërimit të votave të subjekteve të tyre duke lënë kështu brenda qendrave të votimit vetëm komisionarët dhe vëzhguesit e LDK-se. Andaj me këtë rast parashtruesi i ankesës dyshon se votat e tij janë bartur tek kandidatet e tjerë.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në

PZAP nga anëtarët e komisionit të vendotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë i komisionit të Vendotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përputhje me këtë ligj“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrori ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 808/2013 më datën 11.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.